

UDHËZIM
Nr.1547, datë 27.8.2009

**PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË
INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË
PËRKUJDESIT SHOQËROR**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 1547-1, datë 11.12.2009)

(i përditësuar)

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:

a) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç	290 lekë;
b) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç	3 0 0

lekë;

c) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç	320 lekë;
d) për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit	330 lekë;
e) për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve	280 lekë;
f) për klientë në qendrat pritëse, rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e tratifikimit sipas kategorive të përfituesve të përcaktuara në gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e” të këtij udhëzimi.	

2. Niveli i kotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:

a) në qendra ditore polivalente	1 5 0
---------------------------------	-------

lekë,

b) në qendrat ditore të zhvillimit	210 lekë,
c) në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç	200 lekë.
d) në shtëpitë e fëmijëve 3-15 vjeç	200 lekë.

3. Niveli i kuotës për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Efektet financiare nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qëndror, të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror për vitin 2010.

5. Udhëzimi nr.303, datë 13.2.2007 “Për nivelin e kotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1.1.2010.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE
SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA**

Viktor Gumi